

KESH sh.a HYRJE

23 MAR 2022

1486

Prot.

Tirane, me 23.03.2022

Nr 235 prot

Drejtuar: KESH sha, perfaqesuar ne administraten z. Ergys Verdho

Lenda: Kërkesë për informacion

I nderuar z. Verdho,

Në Buletin e Njoftimeve Publike nr. 8, datë 24.01.2022, KESH sh.a., ka publikuar **thirrje për shprehje interesi për dhënie me qira të një aseti gjenerues termik nëpërmjet një impiant lundruës**. Sipas këtij publikimi, citojmë "Në përfundim të kesaj procedure, KESH sh.a, shpreson të kontraktojë një kompani ndërkombëtare, ose grup kompanish, që do të paraqesë ofertën më të ulët të pranueshme për dhënie me qira, për një periudhë të përkohshme (2 vjet), të një aseti gjenerues termik të trupëzuar me rrjetin shqiptar të transmetimit të energjisë, duke realizuar, nën përgjegjësinë e vet, aktivitetet për operimin dhe mirëmbajtjen (O&M) e asetit gjatë gjithë periudhës së qiradhenies dhe në përputhje me kërkesat e paraqitura për shfrytëzimin e tij nga ana e KESH sh.a".

Kërkesat teknike të asetit gjenerues janë parashikuar nga institucioni që ju administroni, si më poshtë:

1. Të ketë një fuqi të instaluar prej 110 deri 130 MW. Kapaciteti i instaluar duhet të jetë modular, që të sigurojë fleksibilitet të prodhimit pa çenuar efektivitetin e gjenerimit të impiantit.
2. Imianti të jetë i disponueshëm për tu dhënë me qira për një periudhë jo më pak se 24 (njëzetkatër) muaj, me një klauzole për ndërprerjen e kontratës në 4 (katër) muajt e fundit kundrejt një kompensimi prej jo më shumë se 25% të vlerës së qirasë së mbetur
3. Të përdorë karburant të lëngshëm, si gasoil (LFO) ashtu edhe mazut/solar (HFO)
4. Të ketë një koeficient të gadishmerisë jo më të vogël se 0.85
5. Të funksionojë brenda përcaktimeve të ligjeve shqiptare për ndotjen mjedisore
6. Të furnizojë energjinë elektrike në tensionin 220kV /50Hz duke respektuar parametrat e sigurisë së Sistemit Energjetik Shqiptar.
7. Të jetë i disponueshëm për tu instaluar pranë TFC Vlorë për të shfrytëzuar infrastrukturën nderlidhëse me rrjetin e transmetimit të TFC-it (Linja 220kV TFC Vlorë – Nënstacioni Babice)
8. Të jetë një impiant i lundrueshëm, që të mos zërë hapësirat dhe të mos pengojë aktivitetet për konservimin apo rehabilitimin e TFC-it, gjatë periudhës së qiradhenies.
9. Shërbimi për transmetimin e energjisë nga vendndodhja e impiantit deri tek terminalët e linjës TFC Vlorë-NN Babice, që ndodhen brenda ambientere të TFC Vlorë (jo më larg se 1000m), të sigurohet nga qiradhenesi.

Në thirrjen për shprehje interesi, parashikohet gjithashtu se:

“TTC-i i Vlorës lidhet me rrjetin e transmetimit të Shqipërisë nëpërmjet linjës së transmetimit të tensionit të lartë TTC-i i Vlorës – NS Babinë (220kV / 50Hz) dhe **ka të vendosura depozita karburanti për depozitimin e karburanteve të lëngshëm**”.

Lidhur me detyrimet e KESH sh.a dhe qiramarrësit, ju parashikoni se:

“Qiradhenësi do të sigurojë KESH sh.a., një impiant termik për gjenerimin e energjisë elektrike në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të bëra prezente në këtë Thirrje si dhe do të a kryejë, nën përgjegjësinë e vet, të gjitha aktivitetet e nevojshme për:

Ankorimin e impiantit lundruar duke garantuar sigurinë e tij dhe të mjeteve Brenda basenit Nderlidhjen me rrjetin e transmetimit në përputhje me kërkesat për sigurinë e sistemit. Mirembajtjen e impiantit sipas manualeve dhe procedurave që garantojnë operimin e sigurtë dhe të qendrueshëm të tij. Operimin e impiantit sipas metodologjisë së shfrytëzimit dhe specifikimeve të shterimit të dakordësuar.

KESH sh.a. garanton qiradhenësin se zotëron të drejtat e përdorimit të hapësirës së nevojshme për ankorimin e impiantit lundruar.

KESH sh.a. do të jetë përgjegjës për të drejtën e lidhjes së impiantit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet përkëlidhjes së linjës që ka TTC-i i Vlorës.

KESH sh.a. do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha procedurave me qëllim prokurimin dhe furnizimin e impiantit me karburantin e nevojshëm për funksionim sipas metodologjisë së dakordësuar të shfrytëzimit”.

Për sa më sipër, **redaksia e emisionit investigativ** bazuar në Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kërkon të na vini në dispozicion informacion dhe dokumentacionin përkatës për sa vijon:

1. Procedurën dhe dokumentacionin përkatës mbi të cilën bazohet thirrja për shprehje interesi për dhënie me qira të një aseti gjenerues termik nëpërmjet një impianti lundruar.
2. Sa është vlera e shpallur fituese nga institucioni juaj, për marrjen me qira të asetit gjenerues termik nëpërmjet një impianti lundruar? Duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e shpalljes së operatorit fitues.
3. Në kërkesat teknike të hartuara nga ana e KESH sh.a, operatori ekonomik do të ofrojë me qira asetin gjenerues termik, i cili duhet të përdorë karburant të lëngshëm, si gasoil (LFO) ashtu edhe mazut/solar (HFO). Në këtë aspekt, sa është sasia e karburantit që do të duhet të përdorë aseti gjenerues termik në ditë, muaj, vit dhe gjithë kohëzgjatjen e kontratës së qirasë (2 vjet)?



4. Në detyrimet e KESH sh.a. parashikuar në thirrjen për shprehje interesi, vetë KESH sh.a do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha procedurave me qëllim prokurimin dhe furnizimin e impjantit me karburantin e nevojshëm për funksionim sipas metodologjisë së dakordësuar të shfrytëzimit. Sa është vlera e përlogaritur nga ana juaj për blerje karburanti për funksionimin e asetit gjenerues termik në ditë, muaj, vit dhe gjithë kohëzgjatjen e kontratës së qirasë (2 vjet)?

5. Nga të dhënat që ne disponojmë, vlera ditore për furnizim me karburant për funksionimin e asetit gjenerues termik është rreth 70 mijë euro, pra një vlerë mesatare mujore 2 milionë euro, vjetore 25 milionë euro dhe sa gjithë kohëzgjatja e kontratës deri 50 milionë euro. Në kushtet e një krize karburanti dhe rritjes së çmimit të tij, a mendoni se institucioni juaj dhe shteti shqiptar mund të përballojë një kosto kaq të lartë për vënien në punë të tij?

Lutemi dërgimin e informacionit brenda afatit 10 ditor të përcaktuar nga ligji, duke bashkangjitur dokumentacionin përkatës.

Ju faleminderit!

Redaksia e emisioni investigativ

Adresa: _____

Email: _____

Tel: _____